REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
DREJTORIA JURIDIKE DHE BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 2919/1 Prot

Tiranë, më 11 / 11 /2026

Lënda: Njoftim për vend të lirë

DREJTORISË SË MARRËDHENIEVE ME PUBLIKUN

KËTU

SHKOLLËS SË MESME PROFESIONALE "SHËN JOZEFI PUNËTOR" RRËSHEN

Në zbatim të Ligjit nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Ligjit nr.15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Ligjit nr.7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.554 datë 31.07.2019 "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive" i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit nr. 759, datë 30.09.2024 "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë, menaxhimin e burimeve njerëzore, përbërjen e njësisë së zhvillimit të institucioneve, ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit" i ndryshuar dhe shkresës nr. 459 prot, datë 04.11.2026 "Njoftim për lëvizje paralele" të Shkollës së Mesme Profesionale "Shën Jozefi Punëtor" Rrëshen, protokolluar pranë AKPA-s me nr. 2919 prot, datë 05.11.2026, ju njoftojmë shpalljen për vend të lirë si më poshtë:

Pozicioni i punës:

- Zëvendësdrejtor në Shkollën e Mesme Profesionale "Shën Jozefi Punëtor" Rrëshen

Kandidati aplikues për pozicionin e punës Zëvendësdrejtor në Shkollën e Mesme Profesionale "Shën Jozefi Punëtor" Rrëshen, duhet të përmbushë kriteret si më poshtë:

1. **Kritere të përgjithshme**:

a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
e) të demostrojë vlera ta larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
f) të demostrojë aftësi të organizimit dhe planifikimit strategjik, aftësi analitike për zgjidhjen e problemeve
g) të demostrojë aftësi drejtuese, të punës në grup dhe motivimit.

2. **Kritere të posaçme për zëvendësdrejtorin që mbulon kulturën profesionale**:

a) të ketë diplomë të studimeve universitare të nivelit "Bachelor" dhe "Master shkencor" (ose të barasvlershme) në një nga fushat që lidhet me kualifikimet profesionale të ofruesit publik të AFP-së;
b) të ketë të paktën kategorinë "Mësues i kualifikuar";
c) të jetë vlerësuar të paktën "Mirë" në provimin e kualifikimit;
d) të ketë njohuri të certifikuara në përdorimin e teknologjisë së informacionit;
e) preferohet të ketë njohuri të gjuhës angleze dhe/ose të gjuhëve të huaja të tjera.

3. Dokumentet e aplikimit

Dosja e aplikimit duhet të përfshijë:

a) letërmotivimin për pozicionin;

b) jetëshkrimin (CV-në), i cili plotësohet sipas formatit në shtojcën 11 të Udhëzimit të Ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit nr. 759, datë 30.09.2024 "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë, menaxhimin e burimeve njerëzore, përbërjen e njësisë së zhvillimit të institucioneve, ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit" i ndryshuar.

c) kartën e identitetit

d) diplomën

e) librezën e punës

f) çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura jetëshkrim;

g) certifikatë/a ose dëshmi për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;

h) vërtetim të gjendjes shëndetësore;

i) vërtetim të gjendjes gjyqësore;

j) vërtetim nga punëdhënësi i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi;

k) të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënës të mëparshëm.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre.

Dokumentat në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyera në gjuhën shqipe dhe të noterizuara.

Afati njoftimit fillon më datë 11.11.2026.

Njoftimi bëhet në faqen zyrtare të AKPA-së, Shkollës së Mesme Profesionale "Shën Jozefi Punëtor" Rrëshen, (nëse ka), si dhe në një vend të dukshëm në hyrje të Shkollës së Mesme Profesionale "Shën Jozefi Punëtor" Rrëshen.

Dokumentet e aplikimit dorëzohen në zyrën e protokollit të Drejtorisë Qendrore të AKPA-së, brenda datës 20.11.2026.

Struktura e vlerësimit të kandidatëve fitues në fazën e dytë është si më poshtë:

- Vlerësimi për dokumentacionin e dorëzuar është 40 pikë;

- Vlerësimi për kriteret e tjera nëpërmjet intervistës me gojë është 60 pikë.

Në intervistë, ndër të tjerat, kandidati vlerësohet për:

i. njohuritë e përgjithshme mbi legjislacionin, mbi të cilin rregullohet dhe organizohet veprimtaria e ofruesit të AFP-së.
   - Ligjit nr.15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;
   - Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.554 datë 31.07.2019 "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive", i ndryshuar;
   - Udhëzimit të Ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit nr.759, datë 30.09.2024 "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë, menaxhimin e burimeve njerëzore, përbërjen e njësisë së zhvillimit të institucioneve, ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit", i ndryshuar.

ii. perspektivën e tij për planifikimin, organizimin dhe ndjekjen e zhvillimit të procesit mësimor në Shkollën e Mesme Profesionale "Shën Jozefi Punëtor" Rrëshen.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Klevis HYSA